



KUVENDI

Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste

Nr. 1379 Prot.

Tiranë më 01/04 2019

Lënda: Kërkesë për kryerjen e ndryshimeve në Vendimin e Kuvendit nr. 102/2017 “Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Realizimin e Reformës Zgjedhore”, të ndryshuar”

Drejtuar:

Z. Gramoz RUÇI
KRYETAR I KUVENDIT

I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

Me qëllim realizimin e objektit të krijimit të Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për realizimin e Reformës Zgjedhore” dhe përfundimin e punës për miratimin e ndryshimeve të kuadrit ligjor zgjedhor për trajtimin e rekomandimeve të raporteve të OSBE/ODIHR-it për tre zgjedhjet e fundit të viteve 2013, 2015 dhe 2017, propozoj kryerjen e disa ndryshimeve në këtë Vendim, si më poshtë vijon:

1. Z. Damian Gjikhuri të caktohet bashkëkryetar i këtij Komisioni, si përfaqësuesi i Partisë Socialiste.
2. Znj. Blerina Gjylameti të bëhet anëtare e Komisionit, si përfaqësuese e PS.
3. Pranë Komisionit të caktohet, në cilësinë e vëzhguesit, përfaqësuesi i partisë më të madhe të opozitës (PD), sipas rezultatit të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2017, i cili gëzon të drejtat e plota të përcaktuara në pikën VIII si dhe ato të pikës IX të këtij vendimi që i përkasin bashkëkryetarëve të Komisionit.
4. Afati i veprimtarisë së Komisionit të zgjatet deri në datën 5 maj 2019.

Me konsideratë,

Taulant Balla

Kryetar i Grupit Parlamentar



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

PROJEKT-VENDIM

NR. DATË

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR.
102/2017 “PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË POSAÇËM PARLAMENTAR PËR
REALIZIMIN E REFORMËS ZGJEDHORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 77, pika 1, dhe 78, pika 1, të Kushtetutës, si dhe neneve 24 dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në vendimin e Kuvendit nr. 102/2017 “Për ngritjen e komisionit të posaçëm parlamentar për realizimin e reformës zgjedhore”, të ndryshuar,””, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Në pikën V bëhen këto ndryshime:

I. Deputeti Damian Gjiknuri (PS) caktohet bashkëkryetar në vend të deputetes Blerina Gjylameti

II. Deputetja Blerina Gjylameti (PS) caktohet anëtar.

2. Pas pikës IX, shtohet pika IX/1 me përmbajtje si vijon:

“IX/1. Pranë Komisionit caktohet, në cilësinë e vëzhguesit, përfaqësuesi i partisë më të madhe të opozitës(PD), sipas rezultatit të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2017, i cili gëzon të drejtat e plota të përcaktuara në pikën VIII si dhe ato të pikës IX të këtij vendimi që i përkasin bashkëkryetarëve të Komisionit”.

3. Afati i veprimtarisë së Komisionit zgjatjet deri në datën 5 maj 2019.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën __. 04.2019